



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.1203/1 prot.

Tiranë, më 11.07.2023

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE TË EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 11548/3 prot., datë 07.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1203 prot., datë 10.07.2023, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “projektligji”), si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i projektaktit, Zyra e Komisionerit vlerëson se pavarësisht argumentit të dhënë se, “Afatit 3 vjeçar për ruajtjen e të dhënave të lojtarëve është gjykuar si një afat i mjaftueshëm dhe normal” nuk identifikohet qartë qëllimi i ndryshimit të afatit për ruajtjen e të dhënave të identitetit të çdo lojtari, nga ana e administratorit të basteve sportive, për një periudhë 3 vjeçare, e parë kjo edhe krahasimisht me parashikimin e nenit 26, pika 2, germa d, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili e lidh ruajtjen e të dhënave me shumën e luajtur ose të fituar në vlerën 100 000, (njëqind mijë) lekë.

Zyra e Komisionerit sugjeron vlerësimin nga ana juaj, të faktit nëse është proporcionale në raport me qëllimin e krijimit të këtij regjistri, ruajtja e të dhënave të identitetit në çdo lojtari/subjekti të të dhënave për një afat 3 (tre) vjeçar, edhe kur shuma e luajtur ose të fituar është minimale. Kryerja e këtij vlerësimi duhet të bëhet duke mbajtur në konsideratë mbingarkesën e mundshme në të dhëna personale, të cilat nuk i shërbejnë qëllimit të përpunimit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit i qëndron sugjerimit të bërë me shkresën nr. 1177/1 prot., datë 30.06.2023, me përfshirjen e të cilit, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi